



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Këshilli i Ministrave**

**V E N D I M**  
**Nr.821, datë 18.06.2008**

**PËR**

**NJË PËRJASHTIM NGA VENDIMI Nr.53, DATË 16.01.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, PËR DISA MALLRA DHE SHËRBIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË".**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

Përfundimisht, për të gjithë vitin kalendarik 2008, procedurat e prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, të kryhen nga vetë autoritetet kontraktore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**

**SALI BERISHA**